



R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë

**AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI KONKURENCËS**

Nr. 608 / prot. 7

Tiranë, më 05.12.20 22

VENDIM

Nr. 927 Datë 05.12.2022

“ MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË EVAG EMDER VERKEHRS UND AUTOMOTIVE MBH DHE ELAG EMDER LAGERHAUS UND AUTOMOTIVE GMBH NGA SHOQËRIA VOLKSWAGEN GROUP SERVICES GMBH ”.

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

| | | |
|------|-----------------|------------|
| Z. | Denar BIBA | Kryetar |
| Znj. | Leida MATJA | Zv/Kryetar |
| Znj. | Adriana BERBERI | Anëtar |
| Znj. | Rezana KONOMI | Anëtar |
| Z. | Durim KRAJA | Anëtar |

Në mbledhjen e tij të datës 05.12.2022, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Evag Emders Verkehrs Und Automotive mbH dhe Elag Emders Lagerhaus Und Automotive GmbH nga shoqëria Volkswagen Group Services GmbH.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Evag Emders Verkehrs Und Automotive mbH dhe Elag Emders Lagerhaus Und Automotive GmbH nga shoqëria Volkswagen Group Services GmbH

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar njoftimi mbi përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Evag Emders Verkehrs Und Automotive mbH dhe Elag Emders Lagerhaus Und Automotive GmbH nga shoqëria Volkswagen Group Services GmbH

Referuar “Marrëveshjes për blerjen e aksioneve”, palët në transaksion janë:

Pala blerëse: Volkswagen Group Services GmbH, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar në regjistrin tregtar të Gjykatës së Rrethit Braunschweig, Gjermani, me objekt aktiviteti: Ofrimi i shërbimeve të kontratës së punës, veçanërisht të natyrës teknike dhe tregtare, kryesisht për kompanitë në Grupin Volkswagen.

Volkswagen Group Services GmbH, zotërohet tërësisht nga Volkswagen Aktiengesellschaft dhe është në pronësi të plotë të Grupit Volkswagen.

Volkswagen Aktiengesellschaft është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit të Gjermanisë, me objekt veprimtarie: Prodhimi dhe shitja e automjeteve dhe motorëve të të gjitha llojeve, pjesëve të tyre si dhe të gjitha sistemeve, makinerive, veglave dhe produkteve të tjera teknike. Volkswagen Aktiengesellschaft është shoqëria mëmë e Volkswagen Group.

Grupi Volkswagen është aktiv në të gjithë botën në zhvillimin, prodhimin, tregtimin dhe shitjen e makinave të pasagjerëve, automjeteve të lehta tregtare, kamionëve, autobusëve, shasive për autobusë dhe motorët me naftë, biçikleta motorike, duke përfshirë edhe prodhimin e pjesëve rezervë dhe pajisjeve shtesë. Grupi Volkswagen gjithashtu angazhohet dhe në shpërndarjen e automjeteve.

Grupi Volkswagen operon në Shqipëri përmes 2 filialeve të mëposhtme:

Porsche Leasing SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar dhe me objekt aktiviteti: veprimtari e qirasë financiare, agjent në sigurime.

Porsche Albania SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar dhe me objekt aktiviteti: shitje me shumicë dhe pakicë të automjeteve të të gjitha llojeve, pjesëve dhe aksesorëve të tyre, kryerje e riparimeve të të gjitha llojeve të automjeteve, përfshirë montimin e automjeteve të përfunduara, modifikim i automjeteve dhe prodhim i pjesëve dhe aksesorëve, etj.

Pala Shitëse: Schenker Aktiengesellschaft, është një shoqëri aksionare, e regjistruar në regjistrin tregtar të Gjykatës së qarkut Essen, Gjermani dhe me objekt aktiviteti: Dërgimi kombëtar dhe ndërkombëtar nga toka, deti, ajri, përfundimi dhe zbatimi i transaksioneve të mallrave, ofrimi i shërbimeve të tjera logjistike, etj.

Pala shitëse zotërohet 100% nga shoqëria Deutsche Bahn AG, një shoqëri aksionare dhe kompania kombëtare hekurudhore e Gjermanisë, me seli në Bahntower në Berlin. Kompania është në pronësi të plotë të Republikës Federale të Gjermanisë, e përfaqësuar nga Ministria Federale për Çështjet Dixhitale dhe Transportin (BMDV).

Shoqëria Target: Evag Emders Verkehrs Und Automotive mbH (Evag), është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar në regjistrin tregtar të Gjykatës së qarkut Aurich, Gjermani, me objekt aktiviteti: Zhvillimin, organizimin dhe realizimin e transaksioneve kombëtare dhe ndërkombëtare të mallrave, administrimin dhe magazinimin e të gjitha llojeve si dhe planifikimi, organizimi dhe zbatimi i koncepteve të tjera logjistike në fushën e prokurimit, shpërndarjes, prodhimit dhe logjistikës së transportit duke përfshirë shërbimet e konsulencës si dhe agjencinë dhe aktivitetet e ndërmjetësimit, etj.

Shoqëria Evag Emders Verkehrs Und Automotive mbH, është pronari i vetëm i të gjitha aksioneve tek shoqëria Elag Emders Lagerhaus und Automotive GmbH.

Elag Emders Lagerhaus und Automotive GmbH (Elag), është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar në regjistrin tregtar të Gjykatës së Rrethit Aurich, e cila kryesisht i ofron shoqërisë Evag Emders Verkehrs Und Automotive mbH, brenda vendit, personel dhe shërbime inxhinierike të automjeteve. Në veçanti Elag ofron shërbime në lidhje me trajtimin, ruajtjen dhe përpunimin e drithit, ushqimit të kafshëve dhe farave javore. Evag dhe Elag quhen kolektivisht si “Kompanitë Evag” dhe biznesi i operuar nga shoqëritë Evag “Biznesi Evag.

Shoqëria Evag Emders Verkehrs Und Automotive mbH zotëron gjithashtu një aksion me vlerë nominale prej 11.000 euro (korrespondon me 1/3 e kapitalit total aksionar) në shoqërinë Autoport Emden GmbH. Autoport Emden GmbH (Autoport), e cila ofron shërbime në fushën e transportit dhe magazinimit të automobilave dhe përgatit kërkesa të veçanta specifike për klientët për automjetet të të gjitha llojeve, ofron shërbime PDI dhe PVC (Pre Delivery Inspection and Vehicle Preparation Center).

Aksionerët e tjerë të shoqërisë Autoport janë Volkswagen Group Logistics GmbH & Co. OHG dhe Anker-Schiffahrtsgesellschaft GmbH, secila prej të cilave zotëron gjithashtu 1/3 e kapitalit aksionar.

Përqendrimi

Ndërmjet shoqërisë Volkswagen Group Services GmbH dhe shoqërisë Schenker Aktiengesellschaft, është lidhur “Marrëveshje e blerjes dhe transferimit të aksioneve në lidhje me të gjitha aksionet në Evag Emders Verkehrs Und Automotive mbH”, më datë 11 tetor 2022.

Pas transaksionit, Volkswagen Aktiengesellschaft do të zotërojë indirekt (nëpërmjet Volkswagen Group Services GmbH) 100% të aksioneve dhe do të kontrollojë shoqërinë target (Evag Emders Verkehrs Und Automotive mbH dhe Elag Emders Lagerhaus Und Automotive GmbH), me përjashtim të shoqërisë Autoport Emden GmbH, e cila do të vazhdojë të kontrollohet bashkërisht nga Volkswagen Aktiengesellschaft dhe aksionari i mbetur Anker-Schiffahrtsgesellschaft GmbH pas implementimit të transaksionit

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të shoqërive Evag Emders Verkehrs Und Automotive mbH dhe Elag Emders Lagerhaus Und Automotive GmbH nga shoqëria Volkswagen Group Services GmbH, parashikuar në nenin 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

II. Vlerësimi i konkurrencës

Në zbatim të nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i trajtimit (terminal) të ngarkesave por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur.

Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Aktiviteti ekonomik i Evag Emders Verkehrs Und Automotive MBH dhe Elag Emders Lagerhaus Und Automotive GmbH lidhet me trajtimin e ngarkesave në portin detar të Emden, veçanërisht në lidhje me automjetet dhe shërbimet ndihmëse dhe asnjë nga këto shoqëri nuk realizojnë të ardhura në Shqipëri.

Pala blerëse, Volkswagen Group Services GmbH është një filial i Grupit Volkswagen, i cili operon në Shqipëri përmes shoqërive të zotëruar indirekt prej tij: Porsche Albania SHPK dhe Porsche Leasing SHPK, në tregun e shitjes së makinave dhe në tregun e qerasë financiare e sigurime.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Evag Emders Verkehrs Und Automotive mbH dhe Elag Emders Lagerhaus Und Automotive GmbH nga shoqëria Volkswagen Group Services GmbH
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


KOMISIONI I KONKURRENCËS


Leida MATJA

Zv/Kryetar

Rezana KONOMI

Anëtar

Adriana BERBERI

Anëtar

Durim KRAJA

Anëtar

Denar BIBA

Kryetar

